FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION
Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

# Procesverbal

Nga mbledhja e punës së Kuvendit të FPPK-së e mbajtur me 01.03.2026, në Hotel International në Prishtinë me fillim nga ora 15:00 .

Në mbledhje ishin prezent përfaqësues vijues të klubeve ::

1. Alban Hoxha:Kpp Ahmet Hoxha
2. Ridvan Hashani: Kpp Ahmet Hoxha F
3. Ardian Lamaxhema:Kpp Ahmet Hoxha MK
4. Veton Gota:Kpp Bashkimi
5. Jeton Oruqi:Kpp Dardania
6. Skender Zeqiri:Kpp Drita F
7. Gani Pireva: Kpp Drita M
8. Sabit Gashi:Kpp Dukagjini
9. Tahir Hamzaj : Kpp Fitorja Klinë
10. Yll Maloku:Kpp Gani Maloku
11. Adhurim Bllaca:Kpp Gjilani F
12. Agron Brestrovci:Kpp Gjilani M
13. Argjent Ferati: Kpp Hasan Prishtina
14. Burim Kuçi:Kpp Juniku
15. Jahja Tërmkolli:Kpp Kosovari
16. Remzi Shala:Kpp Kvpp Prizreni
17. Rifat Rifati.Kpp Lidhja e Prizrenit
18. Besim Hajdari: Kpp Liria
19. Sheremet Hoti: Kpp Llapusha
20. Qamil Vishaj: Kpp Maestro
21. Gani Zeneli: Kpp Peja F
22. Nita Baymak.Kpp Ponte Prizren
23. Nehat Çitaku:Kpp Shkolla
24. Erroll Karabaxhak.Kpp Shkolla Prizreni
25. Kreshnik Dacaj:Kpp Shqiponjat e zeza
26. Fitim Krasniqi:Kpp TTC Ferizaj
27. Bahri Limolli:Kpp Ulpiana
28. Hekuran Podrimçaku: Kpp Vitomirica
29. Petrit Drenica:Kpp Vushtrria
30. Leoresa Imeri Kpp Vushtrria F

Klubi pa të drejtë vote::

1. Berkan Bajmak:Kpp Kalaja Pz

Munguan përfaqësuesit e klubeve

1. Jeton Azizi:Kpp Artana
2. Lulzim Bajraj: Kpp Istogu
3. Kpp Priping
4. Kpp Prishtina
5. Kpp Prishtina F
6. Kpp Shpresa
7. Bekim Fazlija: Kpp Skenderaj

Pjesëmarrës tjerë: Fadil Luta-Sekretar i përgjithshëm, Blerina Sallaj-anetare bordi, Alban Azemi-anetar i bordit, Albana Krasniqi: zyrtare për administrate dhe financa, Rrita Mulaj-zyrtare për media dhe marketing, Leart Sveqla -Ekspert për Hartimin e Politikave dhe Projekteve Zhvillimore, Samire Jupolli-fotografe.

Kuvendi u monitorua nga dy përfaqësues nga MKRS: Aferdita Fazlija dhe Fidan Shatri si dhe përfaqësuesja nga Koku Teuta Beselica.

**Rendi i ditës**

i miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FPPK-së

1. Caktimi i personit për mbajtjen e Procesverbalit të Kuvendit dhe verifikimit të prezencës së delegatëve;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës së Kuvendit;
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit nga viti 2025;
4. Raporti i regjistrimit për vitin kalendarik 2026;
5. Raporti i Punës së FPPK-së për vitin 2025;
6. Raporti Financiar i FPPK-së për vitin 2025;
7. Raporti i Auditorit për vitin 2025
8. Propozimi i buxhetit të FPPK-së për vitin 2026;
9. Propozimi i Kalendarit të FPPK-së për vitin 2026;
10. Propozimi i shortit të garave ekipore për vitin 2026
11. Plani Strategjik 2025-2030
12. Propozimet për ndryshime në aktet Normative
    a. Ndryshimet në Statut
    b. Rregullorja e Regjistrimit
    c. Rregullorja e Sistemit të Garave
13. Temat e propozuara nga klubet për diskutim në Kuvend:
    12.1. KPP Ahmet Hoxha – propozimet
14. Raporti I drejtorit të përfaqësueses për vitin 2025

15. Shqyrtimi I vlerësimit të më të mirëve për vitin 2025
16. Të ndryshme

**Pika 1.**

**Caktimi i personit për mbajtjen e Procesverbalit të Kuvendit dhe verifikimit të prezencës së delegatëve;**

Kryetari propozoi që procesverbalin ta mbajë Zyrtarja për Administratë dhe Financa, Albanë Krasniqi, propozim i cili u aprovua njëzëri.

Kryetari i FPPK-së, pasi i përshëndeti të pranishmit dhe u uroi mirëseardhje të gjithëve, kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm që të bëhet verifikimi i prezencës së delegatëve. Pas verifikimit, u konstatua se ekziston kuorumi për mbajtjen e Kuvendit, pasi ishin të pranishëm 30 pjesëmarrës me të drejtë vote, nga gjithsej 37 përfaqësues të klubeve anëtare të FPPK-së.

**Pika 2.**

**Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës së Kuvendit;**

Kryetari: Si fillim, do t'i lexoj të gjitha pikat e rendit të ditës. Pasi i lexoi të gjitha pikat, theksoi se në rendin e ditës janë shtuar edhe pikat e propozuara në Kuvendin e kaluar nga KPP Shkolla dhe KPP Liria.

Para se të kalojmë në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, më lejoni t'i rikthehem disa pikave të propozuara nga KPP Shkolla. Në këto pika është kërkuar:

Procesverbali i mbledhjes së ndërprerë të Kuvendit të FPPK-së (datë 22.02.2026). Lidhur me këtë, është kthyer përgjigje përmes e-mailit, duke sqaruar se, sipas rregullave, procesverbali përgatitet dhe shpërndahet vetëm pas përfundimit të plotë të mbledhjes së Kuvendit të punës.

Historiku i llogarisë bankare të FPPK-së për vitin 2025 (duke theksuar se nga viti 2020 ky dokument është shpërndarë delegatëve në çdo Kuvend të mbajtur). Në përgjigje është sqaruar se Statuti i Federatës, si dhe asnjë akt tjetër juridik i saj, nuk e parasheh obligimin për shpërndarjen e historikut të llogarisë bankare.

Raportet e detajuara të të hyrave dhe shpenzimeve për projektet e WTT (të cilat përbëjnë 54.85% të buxhetit të FPPK-së për vitin 2025). Është sqaruar se këto të dhëna janë të përfshira në Raportin Financiar dhe do të diskutohen në kuadër të pikave përkatëse të rendit të ditës.

Raporti i Grupit Punues për vlerësimin e ligjshmërisë dhe përmbushjes së kritereve ligjore, si dhe për vlerësimin e gjendjes faktike të klubeve, si rezultat i shqetësimeve të ngritura për klube fiktive (vendim i Bordit, datë 06.09.2025). Në përgjigje është theksuar se kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar me Statut dhe rregullore, si dhe se kjo çështje është trajtuar nga Komisioni për Regjistrim i Federatës, ndërsa raporti përkatës gjendet në pikën 4 të rendit të ditës.

Një kërkesë që është parashtrua dje në orët e mbrëmjes ka qenë: Raporti Sa i përket Komitetit të Gjyqtarëve, është kërkuar raport lidhur me ecurinë e punës së këtij komiteti gjatë vitit 2025, duke përfshirë listën e plotë të gjyqtarëve dhe referëve të deleguar, evidencën e angazhimit të tyre gjatë vitit 2025, si dhe kriteret e përdorura për delegimin e tyre në garat zyrtare.

Kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe, si e tillë, nuk do të trajtohet në këtë mbledhje. Gjithashtu, një raport i tillë nuk është i paraparë sipas afateve të përcaktuara me Statutin e Federatës së Pingpongut të Kosovës.

Po ashtu, nga KPP Liria është propozuar që në rendin e ditës të shtohen edhe këto dy pika:

- Nominimi dhe zgjedhja e dy anëtarëve të Bordit, të propozuar nga Kryetari i FPPK-së. Në përputhje me Statutin aktual të FPPK-së, është theksuar se njëri nga anëtarët, z. Besim Hajdari, ka dhënë dorëheqje dhe, për rrjedhojë, nevojitet një nominim i ri nga Kryetari. Lidhur me këtë pikë, Kryetari deklaroi se nuk ka shtesa, pasi përgjigjet janë dhënë në Kuvendin e kaluar.
- Raporti i Komisionit për Asete (raport mbi tavolinat dhe paravanët e shpërndarë nëpër klube, si dhe gjendja e tyre në depo deri në momentin e raportimit). Kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe nuk mund të trajtohet në këtë Kuvend.

Kërkesa e fundit, e propozuar nga KPP Drita M nga Gjilani, ishte nëse Federata ka pasur sponsorë gjatë vitit 2025, dhe nëse po, cilët kanë qenë dhe me çfarë vlere. U sqarua se kjo çështje do të trajtohet në kuadër të Raportit të Punës, i cili është në pikën 5 të rendit të ditës.

Në fund, Kryetari pyeti nëse ka ndonjë propozim shtesë për pikën "Të ndryshme".

Nehat Çitaku: Meqenëse ju keni dhënë përgjigje në pyetjet e mia, dëshiroj të jap edhe unë sqarimet e mia lidhur me përgjigjet tuaja. Ne nuk jemi të interesuar që ta ndërpresim përsëri Kuvendin, por jemi të interesuar që çështjet për të cilat kemi interes t'i dimë, t'i paraqesim dhe t'i diskutojmë në Kuvend.

Sa i përket pikës për procesverbalin e mbledhjes së ndërprerë të Kuvendit të FPPK-së (datë 22.02.2026), kërkesa ime ka qenë që procesverbali të na përcillet, pasi në Kuvendin e kaluar kemi zhvilluar diskutime për rreth dy orë.

Tek pika 2, historiku i llogarisë bankare të FPPK-së për vitin 2025, ky dokument që nga viti 2020 i është dorëzuar gjithmonë Kuvendit dhe është kërkuar për hir të transparencës. Kjo kërkesë është bërë edhe nga ju më herët, pra e keni kërkuar vetë në vitet e kaluara.

Tek pika 3, raportet e detajuara të të hyrave dhe shpenzimeve për projektet e WTT, të cilat përbëjnë 54.85% të buxhetit të FPPK-së për vitin 2025, janë kërkuar për shkak se është hera e parë që federata e mbyll vitin me fitim, dhe në bazë të raportit dëshirojmë të kemi një pasqyrë më të qartë.

Sa i përket pikave 4 dhe 5, unë vetëm po i paraqes shqetësimet e klubeve, referëve dhe gjyqtarëve.

Ndërsa tek pika për nominimin dhe zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit, konsideroj se Bordi duhet të kompletohet sot, veçanërisht në rast se ndryshimet statutare nuk kalojnë me 2/3 e

votave. Kjo është dita përfundimtare për propozimet tuaja si Kryetar,edhe pse kjo pikë nuk është përfshirë, konsideroj se duhet të futet në rend të ditës.

Sa i përket pikës 6, nuk konsideroj se duhet të kërkojmë informata shtesë, pasi ju si udhëheqje duhet vetë t'i ofroni këto informata, veçanërisht lidhur me asetet e federatës.

Ndërsa tek pika 7, lidhur me sponsorët, është përmendur se federata ka pasur sponsorë, mirëpo ne nuk kemi informata të qarta se cilët kanë qenë dhe sa ka qenë vlera e tyre, duke pasur parasysh se ne funksionojmë si një komunitet i përbashkët dhe duhet të ketë transparencë të plotë.

Sheremet Hoti: Si fillim, dëshiroj t'i përshëndes të gjithë. Jam i nderuar që jam sot në mesin tuaj. Megjithatë, dua t'ia rikujtoj Kryetarit tri çështje që i konsideroj shumë të rëndësishme. Të qenurit Kryetar i një federate është nder dhe privilegj, por njëkohësisht bart edhe përgjegjësi të madhe.

Së pari, çdo veprim duhet të jetë në përputhje me Statutin e Federatës. Së dyti, për çdo veprim duhet të jepet llogari para këtij Kuvendi, i cili ju ka zgjedhur. Asnjë vendim i Bordit nuk mund të jetë mbi Statutin e Federatës.

Në momentin që nuk veprohet në përputhje me Statutin, vihet në pikëpyetje ushtrimi i funksionit të Kryetarit. Në raste të tilla, çështja e përgjegjësisë dhe e qëndrimit në detyrë duhet të reflektohet seriozisht.

Gjithashtu, personalisht jam ndier i shqetësuar lidhur me emërimin e zëvendësdrejtorit të përfaqësueses së Kosovës. Konsideroj se këto vendime duhet të jenë të arsyetuara dhe në përputhje me aktet normative të federatës. Po ashtu, kërkoj sqarim se në cilin nen të Statutit parashihet që përfaqësuesja kombëtare të ketë zëvendësdrejtor.

Kryetari: Ta keni parasysh se jeni duke përdorur dokumente në Kuvendin e punës, me të cilat tentoni të kontestoni apo shkarkoni strukturën ekzistuese të Federatës, duke u thirrur në letra të cilat pretendohet se janë lëshuar sipas kërkesave personale në vitin 2014, drejtuar Federatës së Pingpongut të Serbisë. Federata e Kosovës me Federatën e Serbisë, si dhe shteti i Kosovës me shtetin e Serbisë, nuk kanë komunikim. Dokumenti në fjalë është i vitit 2014 dhe duhet të sqarohet mënyra se si është siguruar, me çfarë kërkese dhe në çfarë rrethanash është marrë. Po ashtu, duhet pasur parasysh se qytetarët tanë janë duke u gjykuar në Hagë pikërisht me dokumente të lëshuara nga autoritetet e Serbisë pas luftës e këndej.

Ju lutem që të mos dalim jashtë temës, por të diskutojmë pikat e rendit të ditës për të cilat jemi mbledhur.

Ridvan Hashani: Kryetar, ju e dini që Kuvendi i kaluar është ndërprerë pikërisht për shkak se nuk janë përmbushur kërkesat që i kemi propozuar ne. Andaj propozoj që edhe kërkesat tona të përfshihen në rendin e ditës.

Kryetari: Nuk po ju kuptoj plotësisht. Ju kam dhënë përgjigje për të gjitha kërkesat e adresuara. Megjithatë, nëse dëshironi, mund t'i fusim edhe në rendin e ditës në pikën "Të ndryshme". Po ashtu, ju sqaroj se procesverbali dërgohet pas përfundimit të mbledhjes.

Sa i përket historikut të llogarisë bankare, unë nuk mund të votoj në kundërshtim me rregullat dhe Statutin e Federatës, si dhe në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Fidan Shatri: Po i shoh disa diskutime të cilat më shumë po duken si të nxitura nga mëllefi sesa të fokusuara në zhvillimin e federatës. Dua të sqaroj se pasqyra e llogarisë bankare nuk mund të kërkohet në formën që po kërkohet, në bazë të ligjit në fuqi, pasi ajo përmban të dhëna personale të secilit prej jush.Ndërsa sa i përket dokumenteve të tjera zyrtare, qasjes në buxhet dhe sponsorizimeve që ka ndarë ministria për federatën, ju në çdo kohë mund të vini dhe t'i shihni të gjitha raportet dhe të dhënat për të hyrat, për çdo aktivitet dhe për aktivitetet ndërkombëtare të vitit të kaluar. Mendoj se po diskutohet gjatë për të njëjtën çështje dhe nuk po ecet përpara.

Nehati theksoi se vitin e kaluar që na është kërkuar me ngulm historiku bankarë paska qenë gabim, për të cilin duhet kërkim falje.

Kryetari, theksoi se kërkon falje e cila kërkim falje u pranua nga Nehati.

Kryetari: tani të kalojmë në caktimin e Komisionit Verifikues, i cili do të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Pas diskutimeve u vendos që Komisioni Verifikues të përbëhet nga: Ardian Lamaxhema, Alban Hoxha dhe Nita Baymak.

Nehat Çitaku:Unë mendoj që për rendin e ditës duhet të jetë edhe opsioni për, nëse jo qka, sepse nuk jemi të interesuar me ndërpre mbledhjen, nëse nuk kalon rendi i ditës ndërprehet mbledhja, kështuqe nëse nuk kalon rendi i ditës nga ju atëhere duhet te jetë një opsion me disa pika me i fut në rend të ditës nga anëtarët e kuvendit.

Kryetari: Rendi i ditës duhet të miratohet, sepse është në interesin e të gjithëve. Ai përfshin kalendarin e garave, sistemin e garave, strategjinë e zhvillimit dhe ndryshimet statutore. Një çështje që dua ta sqaroj është se ndryshimi i Statutit kërkon shumicë prej 2/3 të votave. Gjithashtu, sipas praktikave dhe statutit të shumicës së federatave, dy anëtarët që propozohen nga Kryetari nuk kanë nevojë të kalojnë për miratim në Kuvend. Megjithatë, Statuti ynë e ka këtë çështje të përcaktuar ndryshe, si një dispozitë të trashëguar. Ne mund të dakordohemi që, në rast se ndryshimet statutore nuk kalojnë, propozimi i Kryetarit për dy anëtarët e Bordit të përfshihet në pikën "Të ndryshme" dhe të hidhet në votim.

Aferdita Fazlija: Të nderuar Kryetar, delegatë, dorën në zemër, unë ju kam përcjellë që nga viti 2000. Nuk ndihem mirë që një federatë e cila lirisht mund të themi se ka qenë "drita në fund të tunelit", si federata e parë që është njohur ndërkombëtarisht, sot po përballet me situata të tilla.Sa i përket rastit konkret, jo vetëm në këtë federatë, por edhe në federata të tjera, kur kandidimi bëhet për Kryetar nga pozita e delegatit, kërkohet maksimumi i transparencës. Forma që dy të propozuarit e Kryetarit të miratohen në Kuvend është një prej formave më demokratike dhe më të mira që e ka vlersuar Ministria, respektivisht Departamenti i Sportit. Arsyeja është se në shumë federata ka ndodhur që në kryesi të përfshihen persona të afërt me Kryetarin, të cilët, dorën në zemër, nuk kanë pasur njohuri të mjaftueshme për sportin, jo vetëm në pingpong, por edhe në sporte të tjera të rëndësishme si futbolli dhe basketbolli.

Kryetari: Faleminderit shumë për fjalët me vend. Do të kalojmë në votim. Po ashtu, dua t'ju bëj me dije se, në rast se votat janë të barabarta, vota e udhëheqësit të Kuvendit është vendimtare, ashtu siç e parasheh Statuti.

Nehati theksoi se po na impononi që të dorzojmë listen e nënshkruar për mocion të kryetarit. E pastaj ai me një pjesë e delegatëve nuk ishin të pajtimit dhe gjysma e tyre u larguan nga salla.

Kryetari kërkoi nga Komisioni Verifikues (kishte mbetur vetëm Alban Hoxha) të konstatonte nëse ekziston kuorumi për vazhdimin e mbledhjes. Pas verifikimit, u konstatua se në sallë ishin të pranishëm 15 delegatë.

Afërdita Fazlija: Nuk mund të vazhdohet mbledhja, pasi kërkohet prezenca e së paku 50% plus 1 të delegatëve.

Në këto rrethana, Kuvendi përfundoi në orën 16:30. Meqenëse nuk kishte kuorum për vazhdim, mbledhja u ndërpre, ndërsa Kryetari njoftoi se shumë shpejt do t'i informojë delegatët për datën e re të mbajtjes së Kuvendit.

Kuvendi i rregullt 01 03 2026 Lista e delegatëve

## Klubet me të drejtë vote

| Nr | EMRI I KLUBIT | KOMUNA | DELEGATI | nr personal | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kpp Ahmet Hoxha | Ferizaj | Alban Hoxha | 1030661784 | |
| 2 | Kpp Ahmet Hoxha F | Ferizaj | Ridvan Hashani | 1011623421 | |
| 3 | Kpp Ahmet Hoxha MK | Ferizaj | Ardian Lamaxhema | 1003437341 | |
| 4 | Kpp Artana | Novobërda | Jeton Azizi | 2005828107 | |
| 5 | Kpp Bashkimi | Prizren | Veton Gota | 1230398450 | |
| 6 | Kpp Dardania | Prishtina | Jeton Oruqi | 1500993584 | |
| 7 | Kpp Drita F | Gjilan | Skender Zeqiri | 1011892376 | |
| 8 | Kpp Drita M | Gjilan | Gani Pireva | 1012887104 | |
| 9 | Kpp Dukagjini | Klinë | Sabit Gashi | 1013478674 | |
| 10 | Kpp Fitorja Klinë | Klinë | Tahir Hamzaj | 1002508296 | |
| 11 | Kpp Gani Maloku | Ferizaj | Yll Maloku | 1004479960 | |
| 12 | Kpp Gjilani F | Gjilan | Adhurim Bllaca | 1002991132 | |
| 13 | Kpp Gjilani M | Gjilan | Agron Brestovci | 2002355127 | |
| 14 | Kpp Hasan Prishtina | Vushtrri | Argjend Ferati | 1231146403 | |
| 15 | Kpp Istogu | Istog | Lulzim Bajraj | 1021552611 | |
| 16 | Kpp Juniku | Junik | Burim Kuçi | 1173532730 | |
| 17 | Kpp Kosovari | Fushëkosovë | Jahja Tërmkolli | 1013538073 | |
| 18 | Kpp KVPP Prizreni | Prizren | Remzi Shala | 1002693930 | |
| 19 | Kpp Lidhja e Prizrenit | Prizren | Rifat Rifati | 1002690922 | |
| 20 | Kpp Liria | Prizren | Besim Hajdari | 1016489456 | |
| 21 | Kpp Llapusha | Malishevë | Sheremet Hoti | 1030852024 | |
| 22 | Kpp Maestro | Peja | Qamil Vishaj | 1009287082 | |
| 23 | Kpp Peja F 2020 | Peja | Gani Zeneli | 2013434517 | |
| 24 | Kpp Ponte Prizren | Prizren | Nita Baymak | 1173417515 | |
| 25 | Kpp Priping | Prishtina | | | |
| 26 | Kpp Prishtina | Prishtina | | | |
| 27 | Kpp Prishtina F | Prishtina | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 28 | Kpp Shkolla | Prishtina | **Nehat Çitaku** | 1004111989 | |
| 29 | Kpp Shkolla Prizreni | Prizren | **Eroll Karabaxhak** | 1016417030 | |
| 30 | Kpp Shpresa | Skenderaj | | | |
| 31 | Kpp Shqiponjat e zeza | Deçan | **Kreshnik Dacaj** | 1008765797 | |
| 32 | Kpp Skenderaj | Skenderaj | **Bekim Fazlija** | 1004825353 | |
| 33 | Kpp TTC Frizaj | Ferizaj | **Fitim Krasniqi** | 1172478286 | |
| 34 | Kpp Ulpiana | Lipjan | **Bahri Limolli** | 1015809228 | |
| 35 | Kpp Vitomirica 2024 | Peje | **Hekuran Podrimçaku** | 1003287269 | |
| 36 | Kpp Vushtrria | Vushtrri | **Petrit Drenica** | 1172782708 | |
| 37 | Kpp Vushtrria F | Vushtrri | **Leoresa Imeri** | 1248151426 | |

33

## Klubet pa të drejtë vote

| Nr | EMRI I KLUBIT | KOMUNA | DELEGAT | | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kpp Kalaja Pz | Prizren | Berkan Bajmak | | |
| 2 | Kpp Lipjani 2015 | Lipjan | | | |

## Pjesëmarrës tjerë

| Nr | Emri | Pozita | Instituti | | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Albanë Krasniqi | Financa | FPPK | | |
| 2 | Samire Jardli | Foto | FPPK Foto | | |
| 3 | Albon Azemi | AB | | | |
| 4 | Rita Malaj | [illegible] | FPPK | | |
| 5 | Blerina Salloj | Anketa [illegible] | FPPK | | |
| 6 | LEART SVEÇLA | Ek. Dos Strategjike | FPPK | | |
| 7 | | | | | |
| 8 | | | | | |
| 9 | FIDAN SHATRI | | | | |
| 10 | Teuta Beqelica | KOK | KOK | Monitorim | |
| 11 | Afrodita Fany | MKRS | - DS | MONITORIM | |